



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 618/5 Prot.

Tiranë, më 27/10/2016

V E N D I M

Nr. 136, Datë 27.10.2016

Për

Evadimin E Materialeve Të Auditimit Të Ushtruar Në Shërbimin Informativ I Shtetit, Mbi “Auditimin E Rregullshmërisë Financiare Të Aktivitetit Ekonomik”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin të paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, si dhe mendimin mbi cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, konstatoj se, në Institucionin e Shërbimit Informativ të Shtetit, vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion janë administruar në përputhje me rregullat dhe standardet buxhetore duke reflektuar sisteme kontrolli të brendshëm dhe menaxhimit financiar të kujdesshëm. Kemi konstatuar se brenda organizatës ka një vlerësim të drejtë të risqeve në realizimin e proceseve duke reflektuar impakt pozitiv në arritjen e objektivave, politikave të njësisë në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pavarësisht nga nevoja për përmirësime të kërkuara bazuar në gjetjet e këtij auditimi.

Në përfundim në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të “*Auditimit financiar*” të ushtruar në Shërbimin Informativ të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i pamodifikuar

Në gjykimin e KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare vjetore të Institucionit të Shërbimit Informativ të Shtetit, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31.12.2015. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pamodifikuar.

B. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Nga auditimi i programimit, aprovimit, detajimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2015, u konstatua se:

a. Në respekt të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nëpunësit autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, te nëpunësi i parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, nga ku konstatojmë se ka diferenca për sa i takon analizës së produkteve. Ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipër përmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të cilat gjatë vitit ushtrimor riskojnë të nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo të qëndrueshëm dhe efektiv;

b. Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

a. Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së informacionit me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangie nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim që ndryshimet në shpenzimeve gjatë vitit të jenë sa më to vogla dhe të kufizohen vetëm në ndryshimet të domosdoshme dhe të pashmangshme.

¹ ISSAI 1700: Objektivi i auditimit është formimi i një opinionit për pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e auditimit dhe shprehja e qartë e opinionit në një raport të shkruar, ku përshkruhet baza e tij.

² ISSAI 1200: Gjatë auditimit financiar, objektiva kryesor të audituesit janë dhënia e një sigurie të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale, në mungesë të mashtrimeve apo gabimeve duke përbërë bazën për shprehjen e opinionit nga audituesi si dhe raportimi në përputhje me standardet dhe gjetjet nga auditimi.

b. Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Për sa më sipër, institucioni mund të përdorë një sërë metodash, por ajo që praktikat më të mira sot rekomandojnë është Metoda e parashikimit të kostos mbështetur mbi Aktivitete³ (duke shpërndarë shpenzimet nëpër qendra kostoje e më pas duke ia shtuar këto kosto shërbimeve të ofruara).

Në vazhdim

GJETJA 2

Nga auditimi u konstatua se, pasqyrat financiare të SHISH janë mbyllur, pa u përfunduar procesi i inventarizimit, i cili është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, e që kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre. Procesi i inventarizimit, referuar sa më sipër “certifikon” vlerat e aktiveve, duke ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Si pasojë, mungesa e kryerjes së një procesi të tillë, në mënyrën e duhur (në kohë e duhur) përpara mbylljes së pasqyrave financiare, cënon nivelin e sigurisë së arsyeshme të audituesve të pavarur, për të njohur dhe pranuar “vlerat” e aktiveve.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Institucioni të marrë masa të përfundojë procesin e inventarizimit, me qëllim kontrollin rreth ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Në përfundim të procesit, komisioni i inventarizimit të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara (nëse do të ketë), për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës. Ky raport, në vijim të shërbejë si bazë për të verifikuar përputhshmërinë e të dhënave me shifrat e reflektuara në pasqyrat financiare të njësisë. Me qëllim përmbylljes, është e rëndësishme që procesi i inventarizimit vjetor, të përfundojë përpara mbylljes së pasqyrave financiare të SHISH.

Menjëherë

GJETJA 3

Për vitin 2014 dhe 2015 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve, rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por njësisia nuk dispononte një **regjistër** të të gjitha aktiveve që zotëron apo që ka në administrim, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 26, e cila përcakton se “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo që ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhurat. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Gjithashtu, nga auditimi i gjendjes në magazina rezultoi se ende ka mallra e materiale me qarkullim shumë të ulët (që nga viti 1999), të cilat rezultojnë që nuk përdoren.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

³ ABC – Activity Based Costing

Nëpunësi Autorizues i njësish brenda strukturës së institucionit, të caktojë nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve, ku duhet të përfshihen si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikohen aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësish dhe ato që gjenden nën administrimin e njësish”.

Institucioni të marrë masa që gjatë procesit të inventarizimit, të konsiderojë me prioritet, identifikimin dhe vlerësimin e asetëve me qarkullim të ulët, arsyet e mos qarkullimit, nivelin e përdorimit ose jo të këtyre asetëve dhe marrjen e masave për nxjerrjen jashtë përdorimit për ato aktive, të cilat në bazë të vlerësimit, kanë humbur cilësinë dhe vlerën e përdorimit. Për materialet që vlerësohen si materiale mbeturinë, skarco, rikupero, etj, të merren masa për t'u dhënë për përdorim të mëtejshëm në destinacionet që cakton vetë institucioni. Për sa më sipër, nevojitet të hartohet një rregullore e brendshme, duke u nisur nga specifikat që paraqet aktiviteti i vetë institucionit. Gjithashtu, për shkak të risqeve të mundshme që mbart ky proces, rekomandojmë të kryhet nën mbikëqyrjen e auditit të brendshëm.

Brenda datës 31.12.2016

GJETJA 4

Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se janë rritur Aktivet e Qëndrueshme të Institucionit gjatë vitit 2014, me burim “Grante të Brendshme në natyrë” (klasa 1059) për shumën 3,588,777 lekë dhe “Grante të huaja në natyrë” (klasa 1069), për vlerën 13,370,818; si edhe gjatë vitit 2015, me burim klasën 1059, për vlerën 16,296,029 lekë dhe klasën 1069, për vlerën 2,021,248. Nga auditimi u konstatua se, në shënimet shpjeguese mungon informacioni rreth këtyre investimeve dhe burimit të financimit për to, në një kohë kur ky zë, zë rreth 35% të total investimeve për vitin 2014 dhe rreth 27% të vitit 2015. Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm (jo vetëm sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 26.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve të marrëveshjeve *me donatore të huaja*”, por edhe sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit SNKP 1, paragrafi 128), të cilat duhet ndër të tjera, të sigurojnë edhe atë informacion shtesë, i cili nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare. Çdo zë i shprehur në këto pasqyra duhet të lidhet me referencën përkatëse të shënimeve shpjeguese.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Institucioni të marrë masa që të pasqyrojë informacionin rreth granteve, por edhe rreth zërave të tjerë materialë, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Informimi gjithëpërfshirës merr rëndësi duke konsideruar se, pasqyrat financiare shërbejnë jo vetëm për të reflektuar situatën financiare të njësish, por ato gjithashtu ofrojnë bazë të shëndoshë për planifikim dhe vendim-marrje. Në mënyrë që mungesa e informacionit të mos çënojë proceset e sipërpërmendura, si edhe të rrisë kuptueshmërinë dhe transparencën e të dhënave, nevojitet identifikim i kujdesshëm i zërave materiale dhe reflektimi i tyre në shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare të institucionit.

Në vazhdim

GJETJA 5

Nga auditimi konstatohet një numër relativisht i lartë i blerjeve kryesisht me natyrë shërbim mirëmbajtjeje, që krijon përshtypjen e copëzimit të fondeve, ndërkohë që prokurimi i shërbimeve është fituar nga operatorë me vlerë më të vogël (edhe pse janë konstatuar raste të kalimit tek oferta e dytë në radhë, në këto raste diferenca është minimale), çfarë tregon për ekzistencën e risqeve potenciale mbi planifikimin jo të kujdesshëm të nevojave, të cilat çënojnë efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Me qëllim menaxhimin efektiv të fondeve, si dhe rritjen e efektivitetit të kontroleve mbi këto fonde, merr rëndësi fokusimi drejt planifikimit të kujdesshëm të nevojave nga ana e institucionit, minimizimi i blerjeve të vogla, si edhe përqendrimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në Aparatin Qendror.

Menjëherë

GJETJA 6

Nga auditimi i planifikimit të nevojave për mallra dhe shërbime u konstatua se, SHISH ka zhvilluar tender me objekt “Furnizime dhe shërbime me ushqim për mensat”, sa i takon funksionimit e zhvillimit të aktivitetit të filialeve të trajnimit dhe kualifikimit të SHISH (Aparatit qendror), në kundërshtim me pikën 1/ç të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe kur ka nevojë ... për mallra.*

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Në vijim, institucioni për këtë rast, por edhe për raste të tjera të ngjashme, të marrë masa që të kryejë një vlerësim të kujdesshëm të nevojave për mallra dhe të vlerësohet sipas qendrave të koston, me qëllim rritjen e efektivitetit të fondeve.

Menjëherë dhe në vazhdim

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R